



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Zyra e Kryetarit

01Nr. 06-26354/2025

Klinë 15.08 /2025

Procesverbal

Nga mbledhja e parë për vitin 2025 e kryetarit të Komunës, z. Zenun Elezaj me qytetarë. Mbajtur me datë 25.06.2025 në orën 10, 00 në sallën e kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi kryetari Elezaj duke përshëndetë të gjithë të pranishmit.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Gjatë viti 2025 sigurisht që janë procedurat e rregullta në momentin që aprovojmë buxhetin. Përpjekjet tona që në fillim janë përgatitjet procedural që të arrijmë ta shpenzojmë buxhetin sipas planit të paraparë. Deri tani kemi arritur mirë duke arritur deri tek 90% të realizimit të planifikimit të shpenzimeve të buxhetit. Raporti i shpenzimeve që ka ndodhë deri me tani figuron si më poshtë. Nga shpenzimet kapitale buxheti i aprovuar 4 milion e 794 mijë e 542 euro është shpenzuar deri me 23 qershor 2 milion e 540 mijë e 773 euro. 52.99%.

Nga kategoria mallra e shpenzime janë shpenzuar 905 mijë e 360 euro ose 50.58%. Nga kategoria Shpenzime Komunale janë shpenzuar 272 mijë e 924 euro ose 59.33%. Nga kategoria Subvencione dhe transfere janë shpenzuar 368 mijë e 476 euro ose 39.77%. Buxheti total pa pagat e qershorit është shpenzuar 7 milion e 738 mijë e 632 euro ose 45.89%. Pra duke e pasur parasysh faktin se deri me datë 1 korrik do të ketë edhe shumë shpenzime të tjera mund të themi se jemi mbi 50% ose mund të themi se e kemi kaluar planin e shpenzimeve kapitale dhe kategorive tjera ekonomike. Ky vit po na përcjell me disa shpenzime të pa planifikuara që janë shpenzimet përmbartimore që lidhen me kontratat kolektive që e kemi thënë se janë të pa drejta sepse ata që kanë firmosur kontratën kolektive nuk është komuna por qeveria që nuk po i njeh ato marrëveshje dhe po na e bartë barrën neve komunave. Nuk është e padrejtë se mësimdhënësit marrin mjetet e tyre por sepse qeveria po na i bartë neve ato shpenzime. Sa i përket projekteve, një nga ato është ai që jemi në bashkëfinancim me ministrinë, ndërtimi i rrugës transite i cili po ecë mirë. Jemi në fazën e realizimit sipas planit dinamik dhe të marrjes së vendimeve për shpronësim. Projekt tjetër më rëndësi është edhe fundërruesi për ujin e pijshëm i cili është në bashkëfinancim me Hidrodrinin dhe Ministria e ekonomisë bashkë me Hidrodrinin. Pjesa e fundërruesit është kryer me sukses dhe e kemi përfunduar që d.m.th. se burimi i ujit është siguruar. Sasia e ujit nga fundërruesit futet në ultra filtra dhe pasi të ndërprerët furnizimi nga uji i Jerinës, komplet do të bëhet vetëm nga fundërruesi. Janë disa problem të kompanisë Hidrodrini. Ne deklartimisht ja kemi dorëzuar fundërruesin Kompanisë rajonale Hidrodrini dhe ata janë komplet

përgjegjës për furnizim me ujë të pijshëm. Unë jam në kontakt të përditshëm me hidrodrinin sepse kemi edhe problemin e furnizimit me ujë të fshatrave Çabiq, Rixhevë, Stapanicë etj. Aty duhet të merret një vendim për shpronësim dhe më pastaj do të shtrihet gypi I ujit dhe do të finalizohet projekti I furnizimit. Projekte të tjera janë në procedura të prokurimit. Me disa po kemi problem nga pak me shpronësime por tani më I kemi kryetarët e fshatrave dhe BL të cilët I falënderoj shumë për angazhimin e tyre. Besoj që vitin e ardhshëm edhe ndriçimi publik do të kompletohet bashkë me asfaltimin e të gjitha rrugëve.

Projektet e tjera mund të jetë kjo që lidhet me unazën e qytetit. Do at kompletojmë deri më datën 5 korrik dhe mos të ketë bllokim kur të vijë diaspora. Nuk po zgjasë më shumë. Po e bart të drejten që të bashkëbisedojmë.

z. Rasim Marmullaku, përfaqësues i një pjesë të BL Jashanicë: Kemi dëgjuar që Klina është shpallur me performancë të mirë, A ka përfutur ndonjë grand komuna nga kjo.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Faleminderit. Këtë vit jemi përfitues afërsisht 400 mijë euro por për këtë performancë do të marrim Grandin vitin e ardhshëm. Jemi një prej komunave të pakta që kemi për të fituar. Janë gjithsejtë 5 komuna e grandit është 18 milion euro.

z. Sokol Krasniqi, kryetar I BL Ujmir: Dëshiroj që të të falënderoj për punën tënde të kryer për banorët e Çabiqit. Në emër të fshatit të falënderoj dhe asnjë vërejtje nuk e ka pasur asnjë banor për ndonjë përçarje politike etj. Edhe në emër të Këshillit Organizativ të festivalit dua të të falënderoj për investimin në Kullën e Mujë Krasniqit. Qe 25 vite askush nuk ka investuar asgjë në atë kullë. Ardhja e juaj ka ndryshuar gjithçka. Në emër të familjes së Mujës, në Emër timin dhe të fshatit Çabiq të Falënderoj. Ke me ,mbet në histori. Faleminderit shumë.

z. Emin Balaj, kryetar I BL Gllarevës: Pasi që të gjithë jemi të vetëdijshëm që kemi hyrë në fazën e temperaturave të larta. Do të ishte mirë që të kemi kujdes nga zjarret. Apeloj që edhe Komuna të ketë kujdes jo vetëm në intervenimet e shpejta por edhe shkakut I mungesës së ujit dhe nevojës për furnizim të banorëve. Banorët presin një zgjidhje të sa më shpejt. Është edhe pronari që kemi problem me shpronësim, do të doja që të deklarohet këtu pasi që është prezent , që ta dimë arsyen.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Ne kemi një vendim të publikuar, një apel për të gjithë qytetarët që të kenë kujdes që mos të shkaktojnë zjarrvënie. Për problemin e shpronësimit mund ta diskutojmë në një rast tjetër. Ne respektojmë të drejtën e pronës deri në fund.


z. Ymer Mërlaku: Falënderoj kryetarin për punën që e ka bërë gjatë dy mandateve të tij, puna shihet por njëkohësisht ka edhe problem. Problem është që të rriten shërbimet sa më të mira. Qytetari të shërbehet sa më mirë dhe sa më shpejt. Kërkesat e tyre duhet të marrin përgjigje. Kemi problem me pronat, publike, shoqërore. Prona publike në Klinë vende vende është e uzurpuar, këmbësori dëshiron që të ketë qasje të lirë. Kemi rastin e Objektit të Benitës ku një pjesë edhe pse është pronë publike figuron si pronë private. Ne kemi kërkuar nga Komuna që të shndërrohet në pronë publike. Të gjitha bizneset nuk duhet at pengojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve. Kemi shumë prona të uzurpuara dhe ndërtime pa leje. Nuk kemi legalizim. Qytetari kërkon shërbime edhe në çështjen e ujit të pijshëm, ne Gremniku nuk kemi qasje. Ceka vetëm

pak tani por ka më shumë. Sidoqoftë unë të falënderoj edhe një herë për punën e mirë të bërë ndër vite dhe dëshiroj që të vazhdosh tutje me punë të mira.

z. Zenun Elezaj, kryetar: faleminderit Ymer. Ndoshta disa probleme që nuk I dimë , I mësojmë, si kjo e tanishme për pronat për të cilat fole në lidhje me atë të Benitës. Në projektin që ka me qenë për trajtimin e zonave kadastrale do të jenë edhe pronat e uzurpuara. Do të bëhet një verifikim I plotë I situatës dhe të gjitha problemet do të trajtohen. Për ujë, Gremniku , me transit është paraparë një gyp që do të bartë ujin deri te udhëkryqi I Gremnikut.

Kryetari falënderoj të gjithë që ishin pjesë e këtij takimi

Procesmbajtës:
Skender Behramaj



Kryetari:
Zenun Elezaj

